



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Tiranë, më 30.01.2025

Lënda: Kthim përgjigje

JONA PLUMBI

Adresa elektronike: jonai@faktoje.al

Nr. Cel: 069 26 80 234

Përshëndetje!

Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion, adresuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore në datën 20.01.2025, nëpërmjet adresës zyrtare elektronike: kontakt@iss.gov.al, referuar pyetjeve të cilave parashtroni ju informojmë si në vijim:

1) Sa është numri i pensionisteve në Republikën e Shqipërisë deri në këtë moment?

Referuar të dhënave të funditvitit 2024, numri në total i pensionisteve, për të gjitha kategorite është **721,398**.

2) Sa pensionistë marrin pension minimal dhe çfarë vlerë ka ky pension?

Në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me ligjin nr. 104, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703/11.5.1993», në nenin 31/1, përcaktohet se: « *Personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92, të këtij ligji* ».

Në zbatim të nenit 92, të ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me ligjin nr. 104, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703/11.5.1993”, duke filluar nga data 01.01.2015, vjetërsia në punë/ periudha e sigurimit e plotë, e kërkuar për pension pleqërie si për gratë edhe për burrat shtohet në mënyrë graduale me nga 4 muaj për çdo vit kalendarik deri në vitin 2032, ndërsa mosha e daljes në pension për gratë, derin në vitin 2032 do të shtohet me nga 2 muaj.

Sa më sipër, sipas nenit 92, të ligjit të sipërcituar, për vitin 2024, mosha e kërkuar për daljen në pension për gratë është 61 vite e 8 muaj dhe vjetërsia në punë/periudha e sigurimit, e plotë, është 38 vite e 4 muaj, ndërsa mosha e daljes në pension për burrat është 65 vjeç dhe vjetërsia në punë është 38 vite e 4 muaj.

Ndërkohë në nenin 32, të ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me ligjin nr. 104, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703/11.5.1993 përcaktohet se:

1. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë.
2. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit, që ka realizuar personi, me periudhën e sigurimit të kërkuar, sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social;
3. Shtesa do të jetë 1 për qind për vit siguri shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas nenit 59, të këtij ligji;
4. **Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social.**

Sa më sipër, bazuar në nenin 32/4 të ligjit nr. 7703/ 11.05.1993, i ndryshuar, pensioni i pleqërisë i cili caktohet pas datës 01.01.2015, nuk mund të jetë më i vogël se masa aktuale pensionit social.

Masa aktuale e pensionit social, pas indeksimit të pensioneve, në zbatim të VKM nr. 582, datë 10.9.2024 « Për indeksimin e pensioneve », nga data 01.10.2024, është në vlerën 9,710 lekë.

Numri i përfituesve që marrin pensioni pleqërie, në nivelin e një pensioni social, deri në fund vitit 2024 është **58, 048 persona**.

3) Për pyetjen: “Sa është pensioni me i ulët në qytete dhe sa pensionistë e marrin atë ?”

Përgjigjen e keni në pikën 2.

4) Për pyetjen: Sa është pensioni me i ulët në fshatra dhe sa është numri i pensionistëve që marrin atë?

Përgjigjen e keni në pikën 2.

Gjithashtu, sqarojmë se, nga data 01.01.2015 e në vijim, në bazë të ligjit 7703/11.05.1993, i ndryshuar, me ligjin nr. 104, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703/11.5.1993” të ndryshuar, *« për personat, të cilëve e drejta për përfitim u lind nga data 01.01.2015 e në vijim dhe kanë periudha sigurimi në ish-kooperativat bujqësore, si dhe periudha të tjera në marrëdhënie pune me shtetin, apo periudha sigurimi pas vitit 1994, për llogaritjen e pensioneve të pleqërisë do të zbatohen nenet 31, 32, 59 dhe 92 të këtij ligji ».*

Për rrjedhojë, nga data 01.01.2015, me ndryshimet ligjore nuk egziston kategorizimi i pensioneve të pleqërisë në pension rural dhe urban, aktualisht kemi përfitues të pensionit të pleqërisë sipas nenit 31, të ligjit 7703/11.5.1993” të ndryshuar.

Kategorizimi i pensioneve të pleqërisë në pension pleqërie rural dhe urban, përdoret vetëm për pensionet e pleqërisë, të caktuara me datë lindje të drejte përpara datës 01.01.2015, në bazë të neneve 31, 32, 59, 92 dhe 93, të Ligjit nr. 7703, 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pensioni i pleqërisë minimal urban, i caktuar në zbatim të neneve 31, 32, 59 dhe 92 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me datë lindje të drejte për përfitim përpara datës 01.01.2015, është indeksuar vit pas viti sipas VKM-ve, për indeksimin e pensioneve dhe në vitin 2024 është **në vlerë 17, 886 lekë.**

Ndërsa pensioni i pleqërisë minimal rural, me datë lindje të drejte për përfitim përpara datës 01.01.2015, i indeksuar vit pas viti sipas VKM-ve për indeksin e pensioneve, në vitin 2024, është **në vlerën 12,248 lekë.**

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!